

URDHËR
Nr. 460, datë 19.8.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, z. Armando Boçe, drejtor i Arkivit Qendror Shtetëror, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen vetëm për firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me organizatën “Family Search”.
3. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror, z. Armando Boçe.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido